



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 23.01.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-1035/24, për z. Kreshnik Ferizi, (ish)Anëtar i Komisionit për Vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit: “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e komunës së Prishtinës”, me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 dhe me numër të brendshëm: 616 22 108 312 - Komuna e Prishtinës, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit në vendimmarrje.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Kreshnik Ferizi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast (DPKI-921/24) ka filluar të trajtohet sipas detyrës zyrtare (ex officio) pas shkrimit të publikuar në portal online¹. Është ngritur dyshimi për konflikt të interesit për z. Kreshnik Ferizi, pasi që i njëjti në cilësi të anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit: “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e komunës së Prishtinës”, me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 dhe me numër të brendshëm: 616 22 108 312, në kuadër të Komunës së Prishtinës (në vijim: Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit), ka marrë pjesë në procesin e vlerësimit të aktivitetit në fjalë, në të cilin aktivitet ka ofertuar dhe është shpërblyer me kontratë grupi i operatorëve ekonomik (OE) “Ardi CC” L.L.C. dhe “Anarch” SH.P.K., ndërkohë që i njëjti, gjithnjë sipas pretendimeve në shkrimeve të referuara, është dyshuar për lidhjen me OE “Anarch” SH.P.K..

Konkretisht në shkrimin e referuar, ndër të tjera, është theksuar se, [...] *Komuna e Prishtinës, shkeli ligjin në kontratën 12 milionëshe për “Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit”, duke caktuar në komision të vlerësimit të ofertave një person i cili nuk ishte pjesë e Komunës së Prishtinës. Anëtar i komisionit për vlerësimin e tenderëve, z. Kreshnik Ferizi, nuk ishte pjesë e Komunës*

¹ <https://dplus.org/ne-media/reagim-publik-nga-d-2/19030>

së Prishtinës, duke qenë se kontrata e tij me Komunën e Prishtinës kishte përfunduar me datën 31.12.2022 [...]. Komisioni i vlerësimit të tenderit për kontratën "Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit", përfundoi raportin dhe vlerësimin e ofertave me datën 29.05.2023, pesë muaj pas përfundimit të angazhimit të z. Kreshnik Ferizi me Komunën e Prishtinës. [...] z. Kreshnik Ferizi, nuk ishte as i angazhuar as si ekspert i jashtëm në kohën kur mori pjesë në komisionin për vlerësimin e ofertave për këtë tender. Përveç pjesëmarrjes së paligjshme në komision të vlerësimit të tenderit, ekziston dyshimi i bazuar për konflikt të interesit, duke qenë se grupi i operatorëve ekonomikë "Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit" ("Ardi CC" L.L.C; "Anarch" S.H.P.K) të cilët u shpallën fitues nga komisioni vlerësues ku anëtar ishte z. Kreshnik Ferizi, ofertuan me dokumentacion, ku vetë z. Kreshnik Ferizi figuronte si bashkëpunëtor i kompanisë "Anarch" S.H.P.K. [...].

Rrjedhimisht, përveç pretendimeve si më lartë për konflikt të interesit, janë ngritur edhe dyshime lidhur me (pa)rregullsinë dhe (kundër)ligjshmërinë e procesit të dhënies së kontratës për Shërbimin e Arkitektit të Kryeqytetit. Mirëpo, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, përkatësisht vetëm nëse paraqet konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, pjesëmarrja e z. Kreshnik Ferizi në cilësi të anëtarit të komisionit, në procesin e vlerësimit dhe dhënies së kontratës për Shërbimin e Arkitektit të Kryeqytetit.

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-1423/24, e ka njoftuar z. Kreshnik Ferizi lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin në Agjenci, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet për konflikt të interesit dhe faktet që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Z. Kreshnik Ferizi, në takimin e mbajtur ka paraqitur qëndrimet dhe argumentet e tij për pretendimet e ngritura për konflikt të interesit. I njëjti ka pranuar se ka qenë pjesë (anëtar) e komisionit vlerësues në procesin e vlerësimit dhe dhënies së kontratës për Shërbimin e Arkitektit të Kryeqytetit, si dhe ka dorëzuar në Agjenci kontratën për punë dhe detyra specifike me Komunën e Prishtinës.

Ka deklaruar se në vitin 2003 ka qenë një herë si praktikant në një kompani tjetër të A. N. aksionar i subjektit "Anarch" SH.P.K., me pas ka qenë i punësuar tek subjekti në fjalë deri në vitin 2005, ndërsa pas këtij viti nuk ka qenë pjesë e këtij subjekti. Gjithashtu, z. Kreshnik Ferizi ka sqaruar se, nuk ka qenë bashkëpunëtor i subjektit "Anarch" SH.P.K. në projektin Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit, përkatësisht nuk ka qenë i përfshirë nga OE për këtë projekt.

Përveç kësaj, më qëllim të sqarimit të situatës gjithnjë në kontest të zbatimit të dispozitave të LPKI-së dhe konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-1071/24, ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës informatat dhe dokumentacionin relevant në lidhje me Kontratën me titull: "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 dhe me numër të brendshëm: 616 22 108 312. Komuna e Prishtinës duke vepruar sipas kërkesës si më lartë, ka dërguar në Agjenci përgjigjen, informatat dhe dokumentacionin e kërkuar, shkresa zyrtare DPKI-1071-1/24.

Gjithashtu, me qëllim të vërtetimit të raporteve eventuale të z. Kreshnik Ferizi me subjektin "Anarch" SH.P.K., Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-1604/24, ka kërkuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) informata nëse ka pasur transaksione të deklaruara ndërmjet tyre. ATK duke vepruar sipas kërkesës si më lartë, ka dërguar në Agjenci përgjigjen zyrtare DPKI-19/25, me informatat e kërkuara, përfshirë edhe informatat plotësuese.

Agjencia, sipas kërkesës ka siguruar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), edhe informatat dhe historikun e biznesit "Tulla Studio" SH.P.K., në të cilin z. Kreshnik Ferizi është njëri nga aksionarët.

Kësisoj, Agjencia pasi ka administruar si prova (vetëm provat që lidhen me vërtetimin e fakteve - pretendimeve për konflikt të interesit) shkrimin në portal online, sqarimet e z. Kreshnik Ferizi të dhëna në takimin e mbajtur, përgjigjen dhe dokumentacionin e dërguar nga Komuna e Prishtinës, përgjigjen dhe dokumentacionin e dërguar nga ATK dhe përgjigjen e ARBK-së, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Sipas Kontratës me numër protokolli 14-112/13-205670/22, e datës 06.09.2022, është konstatuar se Komuna e Prishtinës në cilësi të punëdhënësit dhe z. Kreshnik Ferizi në cilësi të punëmarrësit, kanë lidhë kontratë për punë dhe detyra specifike si ekspert i zhvillimit të projekteve madhore, në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës.

Referuar kontratës si më lartë, perioda e angazhimit të z. Kreshnik Ferizi në pozitën si më lartë ka qenë nga data 01.09.2022 deri më datë 31.12.2022.

Me Vendimin e datës 15.09.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës është formuar Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit: "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 dhe me numër të brendshëm: 616 22 108 312.

Sipas paragrafit 1, pikës 1.4 të këtij vendimi, dhe sipas përgjigjes zyrtare të Komunës së Prishtinës, z. Kreshnik Ferizi ka qenë anëtar (i jashtëm) i komisionit vlerësues si më lartë.

Referuar Raportit të vlerësimit të tenderëve i datës 29.05.2023, rezulton se komisioni vlerësues pas vlerësimit të ofertave për projektin Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit, ka shpërblyer me kontratë grupin e OE-ve "Ardi CC" L.L.C dhe "Anarch" SH.P.K..

Raporti si më lartë është nënshkruar nga pesë (5) anëtarët e komisionit vlerësues, pra edhe nga z. Kreshnik Ferizi, si dhe nga zyrtari përgjegjës i prokurimit në Komunën e Prishtinës (datë 31.05.2023).

Më datë 27.06.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësi të autoritetit kontraktues dhe "Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit" SH.P.K.² në cilësi të OE, kanë lidhë kontratën me titull: "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 dhe me numër të brendshëm: 616 22 108 312.

² I themeluar nga grupi i OE-ve "Ardi CC" L.L.C dhe "Anarch" SH.P.K..

Kontratën për autoritetin kontraktues e ka nënshkruar u.d. Udhëheqësi i Prokurimit në Komunën e Prishtinës (datë 27.06.2023) dhe Kryetari i Komunës së Prishtinës.

Referuar kontratës si më lartë,³ z. Kreshnik Ferizi nuk është pjesë e stafit të paraqitur nga OE përfitues i kontratës, për zbatimin e kësaj kontrate.

Lidhur me pretendimin se z. Kreshnik Ferizi ka qenë bashkëpunëtor i subjektit "Anarch" SH.P.K., në realizimin e një projekti në Albania Post në Tiranë, Republika e Shqipërisë, të cilin projekt subjekti "Anarch" SH.P.K. e ka paraqitur si referencë në aplikimin për Shërbimin e Arkitektit të Kryeqytetit, referuar Formularit të dorëzimit të aplikacioneve dhe letër rekomandimit të datës 10.02.2022, rezulton se kontrata për këtë projekt është nënshkruar në vitin 2021, ndërsa projekti është realizuar në vitin 2022.

Përkitazi me paragrafin më sipër, sipas përgjigjes zyrtare të ATK-së, në pyetjen e Agjencisë nëse në pesë (5) vitet e fundit (data 31.05.2018, e tutje), ka pasur transaksione të deklaruara në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërmjet subjekteve: "Anarch" SH.P.K. [...] dhe z. Kreshnik Ferizi, rezulton se [...] nuk janë hasur transaksione [ndërmjet "Anarch" SH.P.K.] me personin fizik Kreshnik Ferizi për periudhat e kërkuara [...].

Rrjedhimisht, nga dokumentacioni në dispozicion nuk është gjetur se z. Kreshnik Ferizi, në periudhën 2021-2022, sikurse është pretenduar, të ketë pasur transaksione që dëshmojnë se i njëjti ka qenë bashkëpunëtor i "Anarch" SH.P.K., në projektin Albania Post në Tiranë.

Referuar përgjigjes së ATK-së si më lartë, subjekti "Anarch" SH.P.K. në vitin 2020-2021, ka pasur transaksione të deklaruara (fatura dhe pagesa) me subjektin "Tulla Studio" SH.P.K., ndërkohë që sipas përgjigjes së ARBK-së, z. Kreshnik Ferizi është njëri nga aksionarët (50% të aksioneve) e këtij subjekti.

Lidhur me pyetjen e Agjencisë drejtuar Komunës së Prishtinës, nëse gjatë procesit të vlerësimit të tenderit, ka pasur ndonjë kërkesë prej aplikantëve për përjashtim nga procedura të anëtarëve të komisionit dhe a ka pasur ndonjë deklaram të konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit, në raport me Operatorët Ekonomik që kanë aplikuar, Komuna e Prishtinës është përgjigjur se, gjatë procesit të vlerësimit nuk ka pasur ndonjë kërkesë prej aplikantëve për përjashtim nga procedura të anëtarëve të komisionit dhe nuk ka pasur asnjë deklaram nga ndonjëri nga anëtarët e komisionit të vlerësimit për konflikt të interesit.

Andaj, në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 dhe nenit 17 lidhur me nenin 3 të LPKI-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me vendimmarrjen e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë interes privat për vete apo për personat e afërm me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: "Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij

³ Faqe 36 e tutje e Kontratës [c. Organizimi dhe stafi].

zyrtare”, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: “Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose **të personave të afërm** me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: “interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, **të afërmit**, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”, dhe nënparagrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se: “**Person i afërm me zyrtarin** është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, **personi juridik konsiderohet si person i afërm**, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Si dhe nënparagrafi 1.12, me të cilin është e definuar nocioni i vendimmarrje si: “çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”

Kësisoj, me nenin 113 [Përkufizimet], paragrafi 6, të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës është përcaktuar se: “Person juridik - subjekti juridik i vendit apo i huaj, i cili sipas legjislacionit të Kosovës në fuqi konsiderohet si person juridik.” Ndërsa me nenin 417 [Konflikti i interesit], paragrafi 5 të këtij kodi, është përkufizuar se: “Për qëllime të këtij neni, shprehja ‘person juridik që ka të bëjë me të’ - nënkupton personin juridik në të cilin **zyrtari apo anëtar i familjes ka marrëdhënie financiare aktuale apo të ardhshme**, përfshirë marrëdhënien afariste ose të punës apo dobi financiare të çfarëdo natyre.

Në rastin konkret, subjekti “Anarch” SH.P.K., sipas nenit 75, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L - 016 për shoqëritë tregtare, ka status të *personit juridik*, por në kuptim të dispozitave të sipërcituara, nuk konsiderohet *person juridik i afërm* me z. Kreshnik Ferizi.

Kjo për faktin se, nuk është konstatuar se z. Kreshnik Ferizi (si person fizik) të ketë pasur marrëdhënie financiare (në kuptim të nenit 417, paragrafi 5 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës), as në kohën kur e ka bërë vlerësimin e tenderit (aktuale) e as pas dhënies së tenderit (në të ardhmen), me subjektin “Anarch” SH.P.K.

Ndërsa, lidhur me faktin se subjekti “Anarch” SH.P.K. në vitin 2020-2021, ka pasur transaksione të deklaruara (fatura dhe pagesa) me subjektin “Tulla Studio” SH.P.K., ndërkohë që sipas përgjigjes së ARBK-së, z. Kreshnik Ferizi është njëri nga aksionarët e këtij subjekti, Agjencia me qëllim të sqarimit të statusit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.) dhe raportit të kësaj shoqërie me pronarët/aksionarët, i është referuar Ligjit Nr. 06/L -016 për shoqëritë tregtare, ku me nenin 75, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L -016 për shoqëritë tregtare është përcaktuar se: “Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është **person juridik** e cila është

juridikisht e ndarë nga aksionarët. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është vetvetiu bartëse e të drejtave dhe obligimeve."

Kësisoj, është vërtetuar se subjekti "Tullat Studio" SH.P.K., dhe personi fizik z. Kreshnik Ferizi, njëherit njëri nga aksionarët e këtij subjekti, janë subjekte të ndryshme dhe juridikisht të ndara nga njëra - tjetra. Andaj, as ky fakt nuk e bën z. Kreshnik Ferizi person të afërm me subjektin "Anarch" SH.P.K..


Shto kësaj faktin se sipas përgjigjes së ATK-së, transaksionet e deklaruar (fatura dhe pagesa) ndërmjet "Anarch" SH.P.K. dhe "Tulla Studio" SH.P.K., kanë ndodhur në të kaluarën, përkatësisht në vitin 2020-2021, d.m.th. nuk kanë qenë as *aktuale* në kohën e dhënies së tenderit, e as *të ardhshme* pas dhënies së tenderit. Rrjedhimisht, transaksionet e tilla, në kuptim të nenit 417, paragrafi 5 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, nuk e bëjnë subjektin "Anarch" SH.P.K. person juridik të afërm me z. Kreshnik Ferizi.

Në këtë kontekst, është fakt se z. Kreshnik Ferizi në cilësi të anëtarit të komisionit vlerësues ka qenë pjesë e procesit (vendimmarrës) të vlerësimit të ofertave dhe rekomandimit për dhënien e kontratës për tenderin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit, ku subjekti "Anarch" SH.P.K. është shpërblyer me kontratë, por subjekti në fjalë (siç u tha më lartë) nuk konsiderohet person juridik i afërm i z. Kreshnik Ferizi.

Kësisoj, pjesmarrja e zyrtarit në *vendimmarrje* dhe ekzistimi i interesit privat apo *interesit të personave të afërm* të zyrtarit në atë *vendimmarrje*, janë kushte *kumulative* të cilat duhet të plotësohen në çdo rast për t'u konsideruar se ka konflikt të interesit në vendimmarrje, sipas dispozitave të nenit 6 dhe nenit 17 të LPKI-së. Në këtë rast, siç është konstatuar më lartë, z. Kreshnik Ferizi ka marrë pjesë në *vendimmarrje* me rastin e vlerësimit të ofertave për tenderin të cilin e ka fituar subjekti "Anarch" SH.P.K., por këtu nuk është plotësuar *kushti* tjetër kumulativ, që është *interesit të personave të afërm* të zyrtarit.

Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: "*Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.*", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: "*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*"

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Ilir Bulçshkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- z. Kreshnik Ferizi;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)